

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE

"CREATE WORK" SH.P.K

Sot me date 28.07.2020

- > **RAFFAELE ROLLO**, atesia (**LUIGI**), shtetas italian, lindur me 19/02/1972, ne San Pietro Vernotico, Brindisi , hall dhe banues ne Lecce (LE) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YA 1526855

- > **VETRUGNO FERDINANDO**, atesia (**ANGELO**), shtetas italian, lindur me 21/03/1947, ne **VEGLIE** , Lecce (LE) Itali dhe banues ne **VEGLIE** ,Lecce(LE) madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YA2924971

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDREN KOMBETARE TE BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date 28.07.2020, u themelua shoceria me pergjegjesi te kufizuar me emrin **"CREATE WORK" SH.P.K**
2. Themeluesit e shogerise jane:



➤ *RAFFAELE ROLLO, atesia (LUIGI), shtetas italian, lindur me 19/02/1972, ne San Pietro Vernotico, Brindisi , Itali dhe ban ues ne Lecce (LE) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA 1526855*


➤ *VETRUGNO FERDINANDO, atesia (ANGELO), shtetas italian, lindur me 21/03/1947, ne VEGLIE , Lecce (LE) Itali dhe banues ne VEGLIE ,Lecce(LE) madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YA2924971*

NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesai shoqerie do te fete:

1. Kompania do te duhet te kryeje aktivitete bujqesore te cdo iloji, perfshire kultivimin, perptulimin e produkteve bujqesore dhe tregtimin e tyre ne toke ne pronesi, me qira, blerjen e automjeteve dhe makinerive te nevojshme per qellimin e saj to biznesit. Mbareshtimin dhe rritjen e bagetive dhe cdo aktivitet tjeter i lidhur me aktivitetin zooteknik ne pergjithesi.
2. Blerja, shitja, gjithashtu fraksionimi, ristrukturimi, planifikimi dhe te gjitha aktivitetet e vleresimit te pasurive te paluajtshme, si urbane ashtu edhe rurale, per perdorim tregtar, industrial, rezidencial dhe zyre, vleresimet e tyre, marrjen me qira dhe menaxhimin e pasurive.
3. Realizimi i puneve ndertimore ne pergjithesi, punimet =gore perfshire germimet, shkaterrimin, ndertimin e tubave te ujit, kanalizimeve dhe te ngjashme.
4. Investimet ne nclertim, blerje, administrim, tregun e pasurive te paluajtshme "Real Estate".
5. Tregti me shumice dhe pakice, import -eksport te te gjitha produkteve, materialeve te ndertimit dhe makinerive te ndryshme, te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise, te perbere nga produktet bujqesore dhe ushqimore ne pergjithesi, portet dhe aeroportet.



6. Ndertimi i ndertesave te ndryshme industriale, socio-kulturore, civile dhe jo-civile, ndertmu l infrastrukturave, ndertimi i apartamenteve te banimit dhe vilave, kanalizimeve dhe furnizimit me uje, rrugeve, materialeve te ndertimit, rinovimi i ndertesave dhe rindertimi i ndertesave civile dhe jo civile te makinave ndertimore dhe te gjitha produkteve sipas aktivitetit te ndertimit.
7. Gjenerimi i energjise elektrike dhe energjise ne pergjithesi, tregtia me energji elektrike dhe energji ne pergjithesi, tregtimi i produkteve energjetike, blerja e certifikatave te energjise sic jane certifikatat e gjelberta, certifikatat e bardha dhe te ngjashme; sherbime per menaxhimin dhe mirembajtjen e impianteve me koncesion, prodhimin dhe shperndarjen e energjise permes kompanive te sherbimeve ne fushen e energjise.
8. Ekzekutimi i kontratave per veprimtarine e lartpermendur, perfshire ofrimin e sherbimeve, prodhimin e marketingut dhe shitjet per llogari te vet ose ne emer te paleve te treta te energjise ne format e ndryshme te saj, letrat me dere te energjise dhe sherbimet e integruara ne fushen e energjise per kursimin dhe optimizimin (menaxhimi i energjise);
9. Konsulence e pergjithshme
10. Investimi ne tregun e ndertimit, blerje, administrim, shitje te pasurive te paluajtshme Real Estate.
11. Tregtia, shitja, si dhe import-eksporti i produkteve, materialeve te ndertimit dhe makinerive te ndryshme thelbesore per aktivitetin.
12. Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashte Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin.
13. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.



NENL 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise është ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" kati 3, Tirane.

KREU II

KAPITALI

NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do to jete 1000 (njemije) leke i perbere nga dy(2) kuota.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen

➤ *RAFFAELE ROLLO, atesia (LUIGI), shtetas italian, lindur me 19/02/1972, ne San Pietro Vernotico, Brindisi , Itali dhe banues ne Lecce (LE) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA1526855 zoteron 50% te kapitalit te shoqerise me vlere te kuotave 500 lek.*

➤ *VETRUGNO FERDINANDO, atesia (ANGELO), shtetas italian, lindur me 21/03/1947, ne VEGLIE , Lecce (LE) Itali dhe banues ne VEGLIE ,Lecce(LE) madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YA2924971 zoteron 50% te kapitalit te shoqerise me vlere te kuotave 500 lek.*

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likuj datoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vj etore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

- g. Miratimi, i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e manjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregëtarët dhe Shoqerite tregëtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen

e numrit total te votave, jam te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperme nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mbledhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me 3/4 e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme men vendimin per:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autonzuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

> RAFFAELE ROLLO, atesia (LUIGI), shtetas Italian, lindur me 19/02/1972, ne San Pietro Vernotico, Brindisi , Itali dhe banues ne Lecce (LE) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YA1526855


NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane to drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise d) PergatlsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund to kufizojne ose heqin kete te drejte.



NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ndaj të treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet e kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Administratorët të cilët kanë kryer veprime ose here marrëveshje të pa aprovuara nga asambleja, janë përgjegjës për dëmet e sjella shoqërisë dhe përgjigjen personalisht ose solidarisht për pasojat.
2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes së tij dhe të kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

KREU IV

VITI FINANCIAR -EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor, Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përmbushje të kësaj detyre eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

KREU 5

PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shocierite tregtare

NENI 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shocieri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me 3/4 e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shocierite tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22


MOSMARREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te fete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

RAFFAELLE ROLLO


VETROG-NZ FERDINAND


1
1